

Nr. 60/
12

Dt. 24.05.2022

URDHËR

Nr. 17/
11 prot, datë 24.05.2022

PËR

DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR.17, DATË 04.02.2022, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS TË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT"

Mbështetur në nenin 35 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe në nenin 5 dhe 55 të Rregullores së Brendshme të Punës,

KONSTATOJ:

Nisur nga ngarkesa e Seksioneve që janë pjesë e strukturës së institucionit të Avokatit të Popullit, vazhdimisht i është kërkuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, shtimi i numrit të punonjësve. Konkretisht, për vitin 2022, është kërkuar shtimi i numrit të punonjësve me dy pozicion "Ndihmëskomisioner", në Seksionin e Përgjithshëm. Kjo kërkesë është miratuar vetëm për një pozicion, i cili është shtuar në strukturën e Seksionit të Përgjithshëm me Urdhrin nr. 17 datë 04.02.2022. Kjo shtesë nuk i ka plotësuar nevojat e institucionit për mbulimin e fushave të përgjegjësisë dhe ngarkesës së Seksionit të Përgjithshëm, ndaj nevojitet shtimi i kësaj strukture edhe me një pozicion. Nga ana tjetër, duke mbajtur në vëmendje ngarkesën e punës, problematikat, rekomandimet e OPCAT si dhe standardet ndërkombëtare të strukturave simotra të Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës, nevojitet që struktura aktuale e MKPT të ketë në përbërje edhe një ndihmëskomisioner me profesion mjek. Në këto kushte, në funksion të rishpërndarjes së burimeve njerëzore brenda institucionit me qëllim lehtësimin e veprimtarisë së Seksioneve dhe njëkohësisht rritjen e cilësisë së punës,

URDHËROJ:

1. Dy pozicionet “Këshilltar” në kabinetin e Avokatit të Popullit të suprimohen dhe të shpërndahen përkatësisht një pozicion Ndhmëskomisioner në Seksionin e Përgjithshëm, kategoria II-b, dhe një pozicion Ndhmëskomisioner në Seksionin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kategoria II-b.
2. Në Urdhërin nr.17, datë 04.02.2022, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a. Lidhja nr.1, organigrama e institucionit të Avokatit të Popullit, zëvendësohet me të njëjtin numërtim që i bashkëlidhet këtij Urdhëri dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b. Lidhja nr.2, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit zëvendësohet me të njëjtin numërtim që i bashkëlidhet këtij Urdhëri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.


AVOKATI I POPULLIT
ERINDA BALLANCA
